



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHEM EKONOMIK

Njoftim i Takimeve Informuese/trajnimeve

Bashkia Shkodër ju fton të merrni pjesë në ditën e hapur që do të zhvillohet në datën **04.05.2026**, ora **11:00**, në kuadër të thirrjes “Skemë granti për bizneset inovative”.

Gjatë këtij takimi do të prezantohet skema e grantit, e cila u drejtohet të gjithë shtetasve shqiptarë mbi moshën 18 vjeç, banorë të Bashkisë Shkodër, që kanë një ide biznesi ose një biznes ekzistues dhe synojnë të zhvillojnë, përmirësojnë apo zbatojnë procese, produkte ose shërbime inovative.

Nëse mendoni se keni një ide biznesi të suksesshme dhe nuk keni mbështetje financiare, mos hezitoni të aplikoni! Thirrja e Bashkisë Shkodër për bizneset inovative ofron një mundësi për të financuar idenë tuaj të biznesit si dhe ju ofron trajnim intensiv në planifikim biznesi, aftësi në biznes, kërkim për mbështetje të tjera financiare dhe konsultime me këshillues të njohur të fushës.

Fondi për “Skemë granti për bizneset inovative” është projekt i Bashkisë Shkodër i financuar nga fondet e veta.

Skema zbatohet përmes një procesi konkurrues, i cili garanton transparencë dhe konkurrencë të barabartë, duke mbështetur idetë dhe planet e biznesit më cilësore dhe inovative që sigurojnë rezultate të qëndrueshme. Ky proces kalon në dy fazave:

- ✓ **Faza I:** Shpallja e thirrjes dhe dorëzimi i ideve të biznesit;
- ✓ **Faza II:** Trajnimi dhe dorëzimi i planeve të biznesit; *(Për të gjithë aplikimet që për zgjedhen në fazën e I-rë)*

Për të gjithë aplikantët e interesuar që kalojnë Fazën e I-rë, Bashkia Shkodër do të ofrojë edhe trajnim **6-ditor në datat 3 - 10 qershor, ora 10:00 pranë ambjenteve të Bashkisë Shkodër**, me qëllim asistencën në shkrimin e saktë dhe plotësimin korrekt të Formularit të Planit të Biznesit dhe seksioneve të tij dhe dorëzimin e plotë të të gjithë paketës.

Në rastin e trajnimeve që do të zhvillohen pas vlerësimit të aplikimeve për përfituesit e granteve, njoftimi do të bëhet në një moment të dytë.

Informacion të detajuar mbi thirrjen, si dhe paketën e plotë, mund ta gjeni në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër në adresën www.bashkiashkoder.gov.al, ose duke kontaktuar në adresën e email-it planifikimistrategjik@bashkiashkoder.gov.al.

Të gjithë të interesuarit janë të ftuar të marrin pjesë në takimin informues.